



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 118, datë 30.07.2018

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E SHOQËRISË SË BROKERIMIT
“EUROBROKER” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 209 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të neneve 8 e 12 të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit, si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, me propozim të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 7 “Kontributet”, të statutit të shoqërisë së brokerimit “Eurobroker” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, me përmbajtje si vijon:

“Neni 7

Në çastin e krijimit të shoqërisë, kapitali themeltar është 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Ai është i ndarë në 3.500 (tre mijë e pesëqind) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilët janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 1.000 (një mijë) lekë për aksion. Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 3.500, përfshirë numrin e fundit të aksionit. Përbërja e kapitalit themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

Emër Mbiemër	Përqindja	Nr. i aksioneve	Vlera në lekë
Altin Sinani	40%	1.400	1.400.000
Bashkim Kryeziu	40%	1.400	1.400.000
Nereida Bujupi	20%	700	700.000
TOTALI	100%	3.500	3.500.000

Me përjashtim të rasteve të shitjeve ose të transferimit të aksioneve me dëshirën e çdonjërit prej aksionerëve, aksionet do të ruajnë këtë strukturë, në çdo shtrirje të aktivitetit të shoqërisë me degë si shoqëri ndërmjetësimi në shtete të tjera.”

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI